

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Gusht, 2018

Tiranë, më 24 Shtator 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Gusht 2018, është 2.120.822, krahasuar me Gusht 2017, ky tregues rezulton me rritje 21,1 %.


Në Gusht 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 1.449.952. Krahasuar me Gusht 2017, ky numër është rritur me 26,9 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në tetëmujorin e 2018 është 4.397.638 duke u rritur me 16,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Gusht 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Gjermania ka patur rritjen më të madhe me 82,5 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Mali i Zi me 63,5 %.

Në tetëmujorin e 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Gjermania ka patur rritjen më të madhe 36,9 % .

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Gusht 2018, janë 2.184.720 duke shënuar një rritje me 20,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Gusht 2018, është 688.559 krahasuar me Gusht 2017, ky numër është rritur 1,3 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Gusht 2018, është 1.496.161. Krahasuar me Gusht 2017, ky numër është rritur 32,6 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në tetëmujorin 2018, është 3.550.502, duke u rritur 3,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Gusht-17	Gusht- 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Gusht 17	Janar- Gusht 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	1.751.149	2.120.822	21,1	6.950.294	7.858.988	13,1
Shqiptarë	608.951	670.870	10,2	3.184.779	3.461.350	8,7
Të Huaj	1.142.198	1.449.952	26,9	3.765.515	4.397.638	16,8
Dalje gjithsej	1.808.151	2.184.720	20,8	7.172.069	7.981.985	11,3
Shqiptarë	679.433	688.559	1,3	3.439.177	3.550.502	3,2
Të Huaj	1.128.718	1.496.161	32,6	3.732.892	4.431.483	18,7

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Gusht -17	Gusht -18	Ndryshim vjetor (%)	Janar- Gusht 17	Janar- Gusht 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	478.047	669.593	40,1	1.343.863	1.581.224	17,7
Maqedoni	111.575	123.056	10,3	453.281	504.823	11,4
Greqi	64.755	57.028	-11,9	310.661	332.766	7,1
Itali	84.308	114.245	35,5	266.325	314.665	18,2
Angli	29.657	22.025	-25,7	100.283	87.341	-12,9
Mali i zi	58.570	21.376	-63,5	252.609	224.582	-11,1
Poloni	30.668	36.105	17,7	89.378	114.182	27,8
SHBA	19.003	21.032	10,7	76.846	85.735	11,6
Gjermani	25.859	47.205	82,5	88.748	121.466	36,9
Zvicër	12.302	9.934	-19,2	45.651	42.662	-6,5
Të tjera	227.454	328.353	44,4	737.870	988.192	33,9
Gjithsej	1.142.198	1.449.952	26,9	3.765.515	4.397.638	16,8

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Gusht 2017	Gusht 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Gusht 2017	Janar- Gusht 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	1.142.198	1.449.952	26,9	3.765.515	4.397.638	16,8
I. Personale	1.136.255	1.443.066	27,0	3.720.142	4.342.860	16,7
1. Pushime	857.422	958.523	11,8	1.906.664	2.141.545	12,3
2. Vizitë në miq e të afërm	4.827	3.959	-18,0	12.724	13.337	4,8
3. Vizitë ditore	20.979	222.112	958,7	165.541	445.787	169,3
4. Trajtim shëndetësor	48	8	-83,3	317	151	-52,4
5. Qëllime fetare	35	42	20,0	462	557	20,6
6. Vizitorë të tjerë	233.364	233.175	-0,1	1.507.228	1.603.053	6,4
7. Udhëtarë transit	19.580	25.247	28,9	127.206	138.430	8,8
II. Biznes dhe profesionale	5.943	6.886	15,9	45.373	54.778	20,7

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Gusht 2017	150.176	191.430	1.409.543	168.439	231.467	1.408.245
Gusht 2018	180.735	204.989	1.735.098	196.883	249.916	1.737,921
Ndryshimi vjetor (%)	20,3	7,1	23,1	16,9	8,0	23,4
Janar-Gusht 2017	876.241	574.842	5.499.211	860.613	580.715	5.730.741
Janar-Gusht 2018	1.015.540	585.058	6.258.390	982.638	579.990	6.419.357
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	15,9	1,8	13,8	14,2	-0,1	12,0

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>